

Mekanizmi i Llogaridhënies WORLD VISION SHQIPËRI

World Vision është një organizatë ndërkombëtare humanitare e krishterë, zhvillimi komunitar dhe avokatie.

Në Shqipëri, World Vision filloi të punonte në 1999-ën, në përgjigje të krizës së refugjatëve kosovarë. Prej dy dekadash, puna jonë është fokusuar tek zhvillimi dhe mbështetja afatgjatë për fëmijët, adoleshentët e të rinjtë dhe komunitetet më në nevojë në Shqipëri. Ne mbështesim dhe punojmë për fuqizimin e fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve më në nevojë. Mbrojtja e përfshirja sociale, aktivizmi rinor, fuqizim ekonomik për familjet në nevojë, janë fokusi i punës sonë. World Vision angazhohet për të sjellë ndryshim të qëndrueshëm dhe rritjen e mirëqënies për fëmijët dhe familjet në Shqipëri.

SJELLJET E PRITSHME

Punonjësit e World Vision Shqipëri dhe partnerët tanë:

- Duhet të trajtojnë çdo njeri me respekt, dinjitet dhe paanshmëri. Duhet të sillen në mënyrë të besueshme dhe etike.
- Nuk duhet të përdorin dhunë, kërcënim apo të përfshihen në sjellje të dhunshme.
- Nuk duhet të kenë sjellje/ qëndrime/ marrëdhënie që favorizojnë abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve (personave nën 18 vjeç) apo të përfituesve të programit/ projektit.

PROGRAMI YNË SYNON

Fëmijët në Shqipëri të jetojnë në një mjedis gjithëpërfshirës, të sigurt dhe të mbrojtur, me mundësi për të ardhmen e tyre. World Vision në Shqipëri punon në tre sektorë: Mbrojtja e fëmijëve, Edukimi dhe Rinia, si dhe Zhvillimi ekonomik dhe reziliencia në komunitet.

Në këtë kuadër ky poster ka si qëllim informimin e fëmijëve, të rriturve, të çdo partneri apo donatori mbi ekzistencën e Mekanizmit të Llogaridhënies në World Vision Shqipëri. Kjo është një mundësi që u jepet të adresojnë në mënyrën e duhur sugjerimet, mendimet, komentet dhe ankesat që ata mund të kenë për projektet/programet e World Vision Shqipëri.

SI MUND TË NA KONTAKTONI?

Dhënia e mendimit, komenteve mbi punën tonë dhe ankesave është e drejta juaj. Ne i mirëpresim sugjerimet, komentet, mendimet dhe ankesat tuaja në mënyrë që të përmirësojmë punën tonë.

Ju mund të lidheni me ne përmes linjës telefonike 068 40 75 263, nga e hëna në të premte, ora 09.00-15.00 dhe përmes email-it llogaridhenia@wvi.org

Sugjerimet, mendimet, komentet dhe ankesat tuaja do të regjistrohen dhe ju do të merrni një përgjigje duke respektuar të drejtën e konfidencialitetit dhe anonimatit.